





- 2-të gjyqësor
dt 02.12.2022
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA"- SH.P.K



Nr. 486/1 Regj. Nr. 6057

Pogradec më 11.11.2022



LAJMËRIM
"PËR EKZEKUTIM VULLNETAR"

Drejtuar Debitorit: - Kosta Sami Samaraj me datëlindje 23.10.1959, ID F91023102P

Adresa: - Qendër Maliq, Maliq

Maliq

Dorëzuesit: - Marie Nuri Samaraj me datëlindje 15.03.1967, ID G75315348K.

Adresa: - Qendër Maliq, Maliq

Maliq ✓

Për dijëni Kreditorit:- Fondi BESA sh.a, Tiranë

Adresa : Rr "Dritan Hoxha", Laprakë, Tiranë

Tiranë

- Fondi BESA sh.a, Dega Rajonale Nr. 1, Korçë

Adresa : Rruga "Ismail Qemali", P. Kapurani, K 1, Korçë,

Korçë

Në Regjistrin e Titujve Ekzekutivë të Zyrës së Përmbarimit Privat "QEVA" sh.p.k, me kërkesën e palës kreditore Nr. 22296/8 Prot, të datës 21.10.2022, më datën 27.10.2022, është regjistruar çështja përmbarimore me numër 486 regjistri, me palë :

Kreditor : Fondi BESA sh.a.

Debitor : Kosta Sami Samaraj.

Dorëzues : Marie Nuri Samaraj.

Me objekt : Kthim Shume.

Unë përmbaruesi gjyqësor Erzen Qeva, pasi shqyrtova materjalin e plotë të dosjes përmbarimore :

KONSTATOVA :

- Në titullin ekzekutiv, Kontratë Kredie me Nr. 649 Rep, 428 Kol, të datës 31.01.2019, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lëshuar "Urdhrin e Ekzekutimit", vendimin me Nr. 41-2021-3137 (759 UE), të datës 13.10.2021, është vendosur detyrimi i debitorit **Kosta Samaraj dhe dorëzueses Marie Samaraj** të paguajnë detyrimin në shumën **48,195 (Dyzetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë**, në favor të kreditorit "Fondi BESA" sh.a.

-Debitori është i detyruar të paguajë kamat vonesat në bazë të nenit 5, të Ligjit Nr. 48/214 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregëtare" të llogaritura sipas akt- ekspertimit të vlerësuesit Ahmed Guxholli deri më datë **08.11.2022**, në shumën **4,705 (Katër mijë e shtatëqind e pesë) lekë**, në favor të kreditorit Fondi BESA sh.a, si dhe kamatat ligjore ditore pas kësaj date në vlerën **15 (pesëmbëdhjetë) lekë** në ditë deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.

Nr. 135 Posa

-Debitori është i detyruar të paguajë shpenzimet e ekspertit në shumën **9,000 (Nëntë mijë) lekë** sipas faturës elektronike të shitjes me nr. **120/2022**, datë **10.11.2022**.

-Debitori është i detyruar të paguajë tarifën e shërbimit përbarimor sipas Udhëzimit me Nr. 385/7, të datës 28.06.2017, "Për caktimin e tarifave dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat", në shumën **18,000 (Tetëmbëdhjetë mijë) lekë**, me TVSH, si dhe çdo shpenzim tjetër të lindur gjatë ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit sipas nenit 525 të K.Pr. Civile.

Në total detyroheni të paguani shumën 79,900 (Shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) lekë.

Pala kreditore ka kërkuar pranë nesh ekzekutimin e titullit dhe në zbatim të ligjit është i detyrueshëm njoftimi juaj si palë debitore për ekzekutimin e titullit në mënyrë vullnetare.

Për këtë arsye : Në bazë të nenit 517 e 518 të K.Pr.Civile .

K Ë R K O J M Ë :

Kryerjen e ekzekutimit vullnetar të "Urdhrit të Ekzekutimit", vendimit me Nr. 41-2021-3137 (759 UE), të datës 13.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si më poshtë;

-Debitori Kosta Samaraj dhe dorëzanësja Marie Samaraj të paguajnë detyrimin në shumën 79,900 (Shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) lekë, në mënyrë vullnetare brënda 10 (dhjetë) ditësh, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijani.

- Debitorët që refuzojnë ose nuk kryejnë sipas asaj që ka vendosur vendimi i gjykatës do të gjobitet deri në 50.000 (Pesëdhjetë mijë) lekë, deri në ekzekutimin e detyrimit , si dhe kallëzim për ndjekje penale, për pengim ekzekutimi në bazë të nenit 320 të Kodit Penal.

- Derdhja e shumës së mësipërme të kryhet detyrimisht pranë Raiffeisen Bank, në llogarinë e veçantë me Nr. Llog. 0041367009 , IBAN AL79 2024 2004 0000 0000 41367009 SGSBALTX, të Shoqërisë Zyrë e Përbarimit Privat "QEVA" Sh.p.k.

- Bashkëngjitur lajmërimin po j'u përcjellim Aktin e Ekspertimit të datës 10.11.2022 të përgatitur nga Eksperti "Kontabël i Miratuar" Z. Ahmed Guxholli, lidhje 3- faqe.

ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K

PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT

Erzen Z QEVA

